

WORKSHOP-KOLOVICA

DATA: 06.06.2022

ORA: 16:00

VENDI: SHFMU "SHKOLLA E GJELBËR"

PËRMBAJTJA:

- 1.Regjistrimi i pjesëmarrësve
- 2.Qëllimi i takimit
- 3.Prezentimi i vizionit
- 4.Prezentimi i objektivave
- 5.Diskutim me qytetarët për Planin Zhvillimor dhe Hartat Zonale

PJESËMARRËS NË TAKIM

1. Perparim Rama, kryetar i Komunës
- 2.Mimoza Sylejmani, drejtore e Drejtorisë së Planifikimit
3. Arbër Sadiki-Drejtor në Drejtorinë e Urbanizmit

Regjistrimi i pjesëmarrësve

(të bashkëlidhura i gjeni listat e nënshkrimeve)

EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

Të dëgjimit publik me qytetarët e lagjes “Kolovica”, në Prishtinë

Arbër Sadiki, duke i përshëndetur të pranishmit, bëri të ditur se ashtu sikurse edhe në lagjet e tjera, kemi filluar me debate të hapura me qytetarë, që të fillojë ky proces i hartimit të Planit zhvillimor dhe Hartave zonale, duke i marrë të hyrat bazike nga vetë banorët e asaj lagjeje ku jetojnë. Ne jemi të bindur që gabimi në hartimin e deritanishëm të dokumenteve planore ka qenë se është shkuar menjëherë në propozim.

Kryetari, Përparim Rama, iu kërkoi falje të pranishmëve për pamundësinë e pjesëmarrjes në takim, për shkak të një aksidenti si pasojë e motit të lig.

Arbër Sadiki, u shpreh se planet më reale dhe më lehtë të zbatueshme deri sot, janë planet që pikërisht fillojnë me diskutime që në fazën e parë. Fillimisht merren të dhëna prej qytetarëve, analizohen, sigurisht që planet nuk janë vetëm dëshira të pronarëve të tokave, qytetarëve, ndërtuesve, por janë në një mënyrë një lloj kompromisi mes dy palëve, që me i balancuar këto lloj interesash. Ideja pse ne sot kemi ardhur te ju është që edhe t’i marrim nga ju informatat që na duhen, por edhe për të prezantuar problemet që ne i kemi. Ne trashëgojmë një mori planesh që ekzistojnë për lagjen tuaj, por që janë me shumë mangësi. Në procedurën e hartimit të dokumenteve planore, ne kemi probleme me komplet territorin e Republikës, pastaj në lagje të caktuara kjo shprehet më shumë. Për fat të keq, në lagjen tuaj dhe “Kodra e Trimave”, dy lagjet me më shumë problematika, pikërisht për shkak të mospërputhjes së shumë dokumenteve paraprake që duhen për me u realizuar një planifikim i mirë. Për shembull, nëse e shihni këtu (tregohen skicat në projektor), këtu janë me vija të ndryshme të prezantuara, zonat kadastrale që i takojnë njësisë suaj, bashkësitë lokale dhe lagjja si është e zhvilluar realisht. Asnjëra me tjetrën nuk përputhen. Me një planifikim të mirëfilltë këto gjëra do të duhej të përputheshin njëra me tjetrën. Atë që ne po mundohemi me e bërë, tani është pikërisht duke filluar me një riorganizim të kufijve të bashkësisë lokale, pastaj të njëjtit kufij me u përputhur edhe me hartat zonale që po duam t’i zhvillojmë tash e tutje. Problematikat me pronësitë janë gjithandej të shprehura brenda territorit të Komunës. Kemi lloj-lloj problemesh me pronësi, që edhe ju jeni në dijeni për to, dhe pikërisht për këto probleme ka mbetur lagjja e pazhvilluar. Atë që e ne po mendojmë me e bërë këtu, që është e mundshme dhe që është varianti më i mirë, është që përmes asaj që ne po e quajmë “rigjenerim urban”, nuk është një plan që e kemi shpikur ne, por ka funksionuar në shumë vende anë e mbanë botës me probleme të ngjashme, që përmes një riformatimi të lagjeve të banimit, ku përgjithësisht ka parcela të vogla, të cilat nuk mund të zhvillohen, të bashkohen, të rishikohen dhe të kthehen prej një zone për banim individual në një zonë shumëbanesore të tipit të mesëm, duke i balancuar koeficientet me hapësirën publike që do të krijohen. Në shumë lagje që i kemi vizituar, zakonisht janë problematikat e njëjta, shqetësimet, ankesat kërkesat. Qëllim ynë është që ne të bashkëpunojmë në çdo gjë, te jemi si dy partnerë në këtë projekt dhe të mos dëmtohet askush, së bashku të krijojmë një ambient të jetueshëm, dhe me vlera. Ky projekt i madh është vizion i kryetarit të Komunës, i cili edhe është shpalosur gjatë fushatës, do të planifikohet nga Drejtoria e Planifikimit.

Këtu me ne është drejtoresha, Mimoza, dhe do të implementohet nga drejtoria e Urbanizmit.

Me ne është edhe Afërdita, e cila është eksperte në punimin e Hartave zonale.

Ai i luti të pranishmit që për çdo gjë që juve ju shqetëson për lagjen tuaj, kërkesat që keni, mos hezitoni ti thoni, jemi këtu për t'ju dëgjuar, dhe për të biseduar për të gjitha.

Bajram Meqani tha se kam bërë kërkesë disa herë lidhur me rrugën. Rruga jonë është rrugë me banime të reja, jemi 10 familje, por rruga ende nuk është e shtruar, njëherësh të bëhet edhe emërtimi i asaj rruge.

Arbër Sadiki bëri të ditur se për punën e rrugëve të reja, asfaltimin, nuk mund të jap përgjigje konkrete këtu. Është Drejtoria e Investimeve Kapitale, e cila e ka një listë të gjatë të rrugëve që kanë me u asfaltuar gjatë vitit, por unë ju kisha propozuar që të vini në objektin e ri të Komunës, në këtë drejtori, me një kërkesë ose edhe vetëm me u informuar a është edhe kjo rrugë në listën e rrugëve që do të asfaltohen.

Bajram Meqani tha se kërkesën për rrugë e kemi bërë tash e 4 vjet.

Aarbër Sadiki u shpreh se pa dashur me gjuajtur faje, ne po flasim për këto 6 muajt e fundit, prej kur ne kemi filluar me u marrë me këto punë. Keni parasysh që ne Planin e investimeve veç e kemi gjetur, ai i cili ka qene i miratuar, ne gjithçka që jemi duke punuar, jemi duke u përpjekur me ridestinine të buxhetit me i rregulluar gjërat, përndryshe procedura është e tillë që buxheti është aprovuar në fundvitin që shkoi. Unë këtu po e them atë që është vullnet dhe orientim i yni. Ne në çdo rrugë që nuk ka probleme me shpronësim, jemi të interesuar qe në afat sa më të shkurtër me intervenuar. Edhe për emërtim të rrugës bëhet kërkesa dhe shkon përmes Kuvendit të Komunës, por gjithashtu është bërë një komision që i trajton rrugët që janë pa emra.

Aavni Berisha përshëndeti të pranishmit, duke thënë se pata dëshirë të ishte vetë kryetari këtu.

Arbër Sadiki u shpreh, lirisht thuaje se të gjitha do t'i përcillen kryetarit, jemi duke mbajtur proces verbal.

Avni Berisha krejt telashet me ndërtim, me prona, për këtë gjendje që është lagjja jonë, më herët e përmende edhe Kodrën e Trimave, e ka LDK-ja. Personi që është kryetar e përfaqëson kryeqytetin. Jemi ndër lagjet më të vjetra në Prishtinë dhe jemi lagjja që nuk kemi transport publik. Aty ku banoj unë qarkullon linja 7, deri në orën 22.00 ka autobus, nga Kolovica e deri te Teatri bën 25 minuta me autobus, ditën e shtunë ka një herë në 2 orë autobus, ditën e diel nuk qarkullon asnjë autobus. Edhe për fat të keq, numrin më të madh të votave secili kryetar e merr nga Kolovica. Diskriminim për mua është kur linjat publike të Komunës të shtunave dhe të dielave e bëjnë qarkullimin pa bilete, e lagjja jonë nuk ka as transport. Lagjja jonë këtë nuk e ka merituar, është turp. Ne e dimë qe vetëm ato 2 mandate që i ka pasur Shpend Ahmeti, krejt mandatet tjera i ka pasur LDK-ja, ne të gjithë i kemi votuar dhe sot nuk kemi as transport publik. Tjetra, ne ndriçim publik nuk kemi tash e 9 muaj, pas orës 19 nuk ka transport. Unë kam bërë ankesë para 5 vjetëve se nuk kemi autobusë, edhe marr përgjigje qe Inspeksioni ka dalë dhe ka konstatuar që të gjithë autobusët e linjës 7 qarkullojnë rregullisht edhe të dielave. Inspektorët e autobusëve të linjës 7 i ke të gjithë të korruptuar, inspektorët që merren me kontrollimin e artikujve ushqimorë të gjithë janë të korruptuar. Unë di raste e raste qe vijnë i shohin artikujt edhe asgjë. Bashkëpunimi i Komunës, ujësjellësit dhe KEDS-it, pse nuk ka bashkëpunim, secili për veti vjen e punon dhe e len ashtu, Ju si Komunë, a dilni ndonjëherë në vendin e ngjarjes edhe me e pa çka bëjnë, a e shihni rrugën si është bërë?! Është turp, p.sh. nesër me ardhur një kryetar prej Zagrebi, Lubjanës, Tiranës edhe e sheh atë rrugë. A dilni ju përtej sheshit të Prishtinës ndonjëherë e me pa si jetohet, p.sh. në lagjen

“Kolovica”?! Ju jeni duke bërë eksperimente me qytetarët e Kosovës, pse vjen një kryeministër, ju e bllokoni tërë qytetin, vdes njeriu në makinë e nuk ka nga shkon.

Andej nga qendra janë bërë disa vende për biçikleta, e unë me dashtë me dalë me biçikletë duhet me marrë biçiklën në krah se nuk kam nga të eci, me dalë me fëmijë me karroce nuk ke nga ecën, sepse nuk ka trotuar ose është i bllokuar! A keni inspektorë, bashkëpunim me policinë. Autobusi te ne ndalet ku të dojë. Lagjja jone nuk ka çerdhe, nuk ka qendra për të moshuar, nuk ka qendra sportive, nuk kemi trotuare, ambulancën e keni ndërtuar, por nuk ka mjek, qe 23 vjet pas luftës nuk i kemi legalizuar shtëpitë, këto janë hallet tona.

Mmimoza Sylejmani tha se do të përpiqem me t’u përgjigjur me aq sa kam informata për drejtorinë tjera, se ne takohemi 2 herë në javë të gjitha drejtoritë. Do të përpiqem t’i përmbledh të gjitha në mungese të kryetarit. Kryetari e dha arsyen pse shkoi, edhe pse ka pasur shumë dëshirë të jetë këtu, se iniciativa e tij ka qenë për këto takime. Vetë fakti pse jemi këtu pas zgjedhjeve, tregon se kemi ardhur për me iu dëgjuar juve. Sa i përket transportit publik ke të drejtë. Bashkë me BERZH, Komuna e Prishtinës është duke i ridizajnuar të gjitha linjat e trafikut urban. Shumë shpejt do t’i kemi edhe 30 autobusë shtesë, tash i kemi edhe aksionarët e rinj, do të zgjidhet edhe bordi dhe shumë shpejt do të fillojmë me linjat e reja. Për ndriçimin publik, edhe këtu keni të drejtë, i takon Drejtorisë së Shërbimeve Publike, e cila qe 2 vjet është në OSHP. Unë nuk e di a jeni të gjithë të informuar, por OSHP-ja qe 2 vjet nuk ka bord dhe Komuna të gjitha mjetet i ka të bllokuara. Nga 19 janari, unë, Arbri dhe kryetari Rama e kemi marrë mandatin dhe po mundohemi, për atë edhe jemi këtu, qe kur të ridizajnohet lagjja juaj, mos me iu qitë juve para aktit të kryer, por ne jemi duke tentuar që me i marrë të gjitha informacionet, shqetësimet nga ju për lagjen tuaj dhe pastaj me filluar në këtë proces. Drejtoria e Shërbimeve Publike bashkë me Prokurimin, e kanë marrë një hap që të rishpallim tenderin e ri, se jo vetëm Kolovica, por shumica e Prishtinës është në terr për shkak të OSHP-së, sepse OSHP-ja zgjidhet ne nivel qendror. E dimë që nuk ka çerdhe, por sot po ju jap një lajm, që ngjitur me shkollën “Eqrem Çabej”, tashmë është në tender çerdhja e parë që do të ndërtohet këtu. Gjithashtu, një tjetër çerdhe që është në plan në Fushën e Pajtit, projekti është gati, por ujësjellësi nuk ia ka përkthyer tokat ende Komunës së Prishtinës, edhe këtë jemi duke tentuar me bërë marrëveshje. E ceke edhe bashkëpunimin jo të mirë me KEDS-in dhe ujësjellësin, drejtori i Investimeve Kapitale, Krenari, është duke u takuar me ta në baza ditore kisha me thanë, në mënyrë që t’i koordinojmë punët, që deri në vitin 2023 mos të kemi këtë lloj telashje të natyrës së tillë. Kemi raste kur Komuna e ka shtruar rrugën dhe KEDS-i pas 3 javëve ka shkuar pa leje dhe e ka prishur rrugën, ka punuar aty, kjo nuk është në rregull, se është taksa juaj aty, taksa jonë. Për policinë që e cekët, Kryetari ka pasur takim me ministrin Xhelal Sveçla, jemi në bisedime, ne jemi të vetëdijshëm se sa inspektorë i ka Komuna, është një numër jashtëzakonisht i vogël dhe është e pamundshme me i kontrolluar të gjitha. Ne nuk kemi polici komunale, siç e ka Tirana. Kryetari është duke u përpjekur shumë, unë e di që keni pritur shumë, jemi të vetëdijshëm, se edhe unë jetoj në Prishtinë dhe përballem me të njëjtat shqetësime si tuajat.

Imer Rrahmani, kryetar i Bashkësisë Lokale dhe banor i lagjes, theksoi se qytetarët e lagjes sonë ballafaqohen me shumë probleme, një prej tyre është rregullimi i çështjes pronësore, por për rregullimin e kësaj çështje Komuna e Prishtinës, një prej komunave të vetme e aplikon taksën e transaksionit, dhe kjo e rëndon ekonominë familjare, është pengesë për rregullimin e pronës. Për çudi, njëjtë paguan taksë për një njësi 150 euro, dhe njëjtë për pronën e trashëguar nga gjyshi, si trashëgimtar i dorës së dytë. Kjo është shkelje e të drejtave të njeriut. Me këtë standard që jetojmë, kjo taksë është e lartë dhe duhet të hiqet. Në lagjen ku unë jetoj, “Kolovica e Re”, 70% e banorëve jetojnë në prona të trashëguara, e tash

nipat e mbesat duhet të paguajnë taksën. Ju e dini që këto probleme me pronësinë janë të kahershme, njerëzit kanë tokë, por nuk kanë mundur ta legalizojnë pronën, edhe ende këto probleme kanë mbetur pa u zgjidhur. Tani është barrë edhe taksa e transaksionit. Nuk mund t'i gëzojmë disa të drejta, nëse nuk jam pronar, nuk mund të realizoj të drejtën e pasurisë sime. Në rast se largohet taksa, kjo iu jep mundësi qytetarëve që të bëhet rregullimi i pronave dhe krijon stabilitet.

Arbër Sadiki tha se këtu e kemi edhe njërin nga asamblistët që e kanë propozuar heqjen e taksës së transaksionit, ky ka qenë një propozim që është përkrahur prej të gjithëve, por ka mbetur për çështje procedurale pa u vazhduar, por nuk është vetëm Prishtina që e ka një taksë të tillë.

Fisnik Osmani u prezentua para të pranishmëve, duke thënë se jam asamblist nga radhët e LDK-së në Kuvendin e Komunës. Problematikën e çështjes së taksës në transaksion e kemi ngritur në tri mbledhje radhazi. Në takimin e fundit të asamblesë kemi kërkuar nga Drejtoria e Financave, e cila do ta trajtojë, analizojë dhe pasi ta bëjë një analizë të saktë financiare do ta sjellë në Kuvend për miratim, ne jemi të interesuar shumë që ti përkrahim interesat e qytetarëve.

Muhamet Jahiri u shpreh se shpresoj që këto çka po i thoni të bëhen realitet. Plani për çerdhen pothuajse është folur. Unë lirisht mund të them se ka tash e 10 vjet që nuk është investuar as edhe një cent prej Komunës. Ky plani i çerdhes është nisur kaheerë në Fushën e Pajtimit, ku është premtuar edhe një park, që nuk kanë ndodhur as njëra, as tjetra. Aty shumë herë bëhet deponi e mbeturinave dhe gjithnjë rrezikohemi prej qenve endacakë. Sa i përket transportit urban, pajtohemi me parafolësin se janë gjera reale, autobusët që përdoren në linjën 7 janë të viteve të '70-ta, që as nuk përdoren për të bartur ushqim të kafshëve e jo me transportuar njerëz. Kur i sheh aktivitetet e Komunës së Prishtinës, të mbushet mendja që Prishtina e ka vetëm një emër, e që është "Muharrem Fejza". Ne jemi totalisht të përjashtuar. Sa i përket KEDS-it është një dukuri, përveç këtyre punimeve që s'ka koordinim e që janë dëmtuar shumë rrugë, ata nuk janë të dakorduar as me kabllor. Tjetri problem këtu është uzurpimi i hapësirave publike, problem që duhet me u zgjidhur prej Komunës. Nëse nuk mund të iu bëni zgjidhje parcelave private, së paku parcelave të juaja mundeni me iu bërë zgjidhje. Unë besoj se edhe ky vendi ku ka qene pjesë e Ujësllësit, por ka arritur me u bërë marrëveshje dhe është ndërtuar kjo shkollë, Prandaj. mos te neglizhojmë e te gjejmë arsyetime, e në mandate kur te premtoni qe bëni çerdhe ta bëni, e jo ne të shkojmë për çerdhe në lagje tjera e me i lutur që me na i pranuar fëmijët atje. Këto çka po i themi janë gjera emergjente, ndërsa sa i përket planit urbanistik, besoj se ndërtohet prej politikave brenda Komunës, por të paktën këto gjëra t'i merrni si prioritet.

Mimoza Sylejmani tha se për çerdhen në Fushën e Pajtimit ju thashë se jemi në proces të marrëveshjes, ndërsa për çerdhen këtu është në tender. Ju siguroj se shumë shpejt do të behet. Ne e dimë, jemi duke e diskutuar qe sa me Ministrinë e Arsimit për mungesën e çerdhes këtu.

Arber Sadiki u ndërlidh me çështjen e transportit. Ai tha se e cekëm më herët se ne jemi në proces shumë serioz me BERZH-in për punën e transportit, që nuk është i integruar ne tërë qytetin e Prishtinës, transporti nuk funksionon linje pas linje, nuk është krijuar ende plani i mobilitetit. Aty ku jetoj unë është e njëjta gjë, hipni te 6-shi dhe e shihni që nuk është ndryshe nga linja e juaj, është autobus qe ia ke frikën me e pa ne rrugë e jo me hipur ne të. Por, këto nuk bëhen brenda ditës, janë të rralla linjat edhe për pjesën e Arbërisë, është lagjja ku jetoj edhe unë, e kemi të njëjtin hall, ne jemi ajo kategori e drejtorëve që nuk jetojmë në far luks, jetojmë bashke me juve, njëjtë si ju. Ne po përpiqemi me i zgjidhur hallet të cilat na preokupojnë edhe vetë neve. Por ne po mundohemi me i zgjidhur këto probleme në tërësi, në mënyrë të integruar, edhe pikërisht mendojmë se ne i kemi këto probleme, sepse janë zgjidhur aty për

aty, pa analizë, dhe një problem i vogël i zgjidhur i ka krijuar edhe 15 probleme tjera. Nuk jemi duke shpikur ndonjë të re, ashtu siç funksionojnë të gjitha qytetet që ju i përmendët, Zagreb e Lubjanë, që janë qytete që ne vazhdimisht jemi në kontakt për t'i marrë praktikatat e tyre më të mira që me funksionuar edhe ne si gjithë vendet tjera, por nuk po duam të improvizojmë, që për shkak të nxitimit me bërë projekte që nuk kanë sens, e ne ciklin e madh duhet me u lidhur që me funksionuar qyteti në tërësi.

Fitim Jusufi, banor i lagjes, rr. "Haxhi Zeka", tha se kjo pjesa jonë ka mbetur as andej, as këndej, në planin rregullues, të cilin e keni në plan me e bërë. Përveç këtyre problemeve që i cekën banoret e tjerë, a keni ndonjë ide se çka do të bëhet, apo jeni në fazën fillestare. Ju folët edhe për koeficientet, normal që është interes i juaji, se jemi më afër qendrës, por saktësisht a keni ndonjë propozim. Ne jemi si në mes, jetoj 500 metra prej Shkollës Teknike, edhe s'kemi as hapësira publike, s'kemi asgjë edhe ne krejt banoret e kësaj pjese jemi te interesuar për atë zhvillimin që ju e përmendni, se lagjes sonë i mungon shumëçka. Po i shohim lagjet tjera jashtë Prishtinës që i kanë të gjitha, plus jemi me afër Qendrës edhe kemi mbetur me koeficiente që normal ne s'kemi llogari me bërë diçka. Unë mendoj që është zgjidhje me u bërë ndërtim i lartë.

Arbër Sadiki theksoi se qëllimi i shfrytëzimit të një zone të caktuar, duhet me u pa në mënyrë të integruar, jo ndaras. Ju vetë e thatë që po zhvillohet periferia e Prishtinës, por jo qendra, pikërisht për arsye se është punuar në mënyrë parciale. Planet rregulluese të cilat i kemi në fuqi, janë me kufij rigoroz, shpesh aty ky përfundon një plan rregullues fillon një plan i ri. Ndarjet dhe dallimet janë aq të mëdha sa nuk kane kurrfarë sensi, për shkak se janë hartuar në kohë të ndryshme, në vite të ndryshme e për interesa të ndryshme etj etj. Hartën Zonale që ne po e përmendim, është një hartë që është e integruar për gjithë qytetin. Ajo kur hartohet, hartohet brenda gjithë kufijve të zonës urbane ekzistuese. Arsyeja pse bëhen të tilla është pikërisht për me i balancuar lagjet që janë afër njëra-tjetrës e jo me i ndarë.

Sigurisht që secila lagje i ka karakteristikat e veta, se nuk mundet gjithë Prishtina me e pasur një koeficient. Arsyeja pse ne jemi këtu, është për të vlerësuar tokën si kapital, nuk jemi këtu për me iu thënë se këtu kemi me e bërë gjelbërim edhe ty kështu të ka rënë edhe bën çka te duash. Jo, nëse në plan përcaktohet një zonë gjelbëruese ose një çerdhe apo shkollë, me u llogarit se pjesa e asaj toke kompensohet me koeficientin e njëjtë. Ky është plani ekzistues urbanistik i Prishtinës (tregon hartën) aty ki më shumë se 100 p.sh. pika të theksuara, ku kemi me vendosur shkolla dhe çerdhe, kur duam te investojmë. P.sh. nuk e ke as edhe një vend të lirë, për shkak se veç është qitur një shenjë, kurrë nuk është analizuar se si mundet ajo pjese me u shpronësuar, edhe ne sot kemi mjete edhe të nivelit qendror edhe prej donatoreve, edhe s'kemi vend për me e bërë shkollën, e sikur të ish punuar në mënyrë të integruar në tërë territorin e komunës, kish qene shume më lehtë me i balancuar këto problematika.

Fitim Jusufi u shprehu se unë mendoj që jemi të diskriminuar. Me qene 500 metra larg qendrës edhe me mbet kështu është e çuditshme, për atë e thash më herët që ndërtimi i lartë kish me liru hapësira për me i pasur krejt edhe ne, çerdhe e hapësira të gjelbëruara, rrugë me të gjera, për atë e bëna pyetjen po me këto çka i pash, prapë njëjtë doni me na lënë prapë kështu.

Arbër Sadiku pyeti se nëse ju mendoni se ne do ta lëmë ashtu si është, atëherë pse paskemi ardhur ne !? Ne jemi zyrtarë të Komunës që kemi obligim ndaj secilit, s'kemi ardhur as me bërë politikë, as fushatë, kemi ardhur me i pa problemet reale. Të dytë këtu jemi persona në cilësinë e ekspertëve, të dytë jemi inxhinierë të arkitekturës, që pretendojmë se e kemi një ekspertizë që mundemi me e nda me tjerët, e

për me ndarë ne duhet me i pasur informacionet e sakta, që me mundur me e zhvilluar. Nuk ka me pasur plane të veçanta për lagje të veçanta. Harta zonale parashihet me Ligjin për planifikim urban prej 2013-ës, dhe sot jemi në 2022-tën, dhe ato akoma nuk janë bërë. Për me i zhdukur këto parregullsi mes një plani rregullues me një plan tjetër rregullues, parashihet Harta zonale e cila e trajton gjithë territorin urban dhe rural.

Gzim Krasniqi tha se rruga për fshatin Butofc është e prishur, pse nuk po shtrohet ajo rrugë.

Arbër Sadiki theksoi se kjo është pyetje që i takon Drejtorisë së Investimeve Kapitale, e thash edhe më herët, por e di që kryetari e ka në plan edhe pjesën e Butofcit. E kemi thënë edhe më herët që plani është që edhe fshatrat të jenë të përfshira, vendbanime që e pasurojnë jetën e qytetit, e sidomos Butofci, që pozicionin e ka të tillë, shumë premtues.

Avdullah Dushi, banor i lagjes, tha se halle kemi të gjithë, por ne këtu kemi shumë. Tash e 60 vjet jetoj këtu, kam aplikuar 2 herë për leje urbanistike, i kam 30 arë oborr, bashke me djem të axhallarëve, gati 500 arë, tash me një koeficient 1.2 s'po di, me një koeficient më të mirë, p.sh. 1.8 ndoshta ishim marrë vesh. Ramën për këtë e kemi votuar, se është inxhinier e ndoshta me atë mundemi me bashkëpunuar.

Nazim Demolli, po e shoh që problemi më i madh në tërë këto çka folëm është te shpronësimi. Çka do të ndërmerrni ju për qëllim për dallim nga qeverisjet para jush.

Arbër Sadiki theksoi se kur flasim për rigjenerim urban, nevoja për rigjenerim urban ka lind pikërisht në ato lagje ku kanë pasur problem me pronën. Komuna nuk e bën rregullimin e çështjeve të pronës, atë e rregullon Ligji për kadastër, ne nivelin qendror, që e sheh saktë se si bartet prona prej njërit te tjetri. Ne jemi këtu për me iu thënë që me mekanizmat që i lejohen pushtetit komunal me i zgjidhur këto probleme. Këto mekanizma kanë të bëjnë me rigjenerimin urban, ku ti merr një zonë, p.sh. komplet, bashkohen të gjithë ata bashkë për një interes të përbashkët dhe grumbullohen në njësi banesore kur e realizojnë atë interes, por si pronare me letra, me interesin shtesë, i cili mund të diskutohet deri ne masën kur e cenon interesin publik. Sot veç është fillimi i takimeve, herës tjetër kemi me ardhur me projekt, me harta me i diskutuar me secilin pronar, edhe ulemi dhe bëjmë një zgjidhje, duke i kalkuluar të gjitha këto, gjithmonë me një bashkëpunim mes veti.

Petrit Avdullahu, banor i lagjes, tha se në prezentimin që e batë, thatë që i keni 3 plane, cila do të jetë Kolovica në të ardhmen?

Arbër Sadiki, ne po flasim për Kolovicën e cila është brenda planit urbanistik zhvillimor momental që është kjo këtu (tregon hartën).

Petrit Avdullahu, desha të pyes edhe për unazën, ka lëvizje në Kolovicë nga do t'i bie.

Arber Sadiki tha se unaza deri tash ka qene vetëm një gjurme e qitur në hartë prej 2006-ës edhe me kurrë nuk është bërë projekt. Jemi duke e bërë projektin bashke me BERZH-in, projektin zbatues për unazën, gjurmën pothuajse e kemi përcaktuar fiks, tash për tash një prej daljeve është pikërisht në Kolovicë, këtu (tregon hartën), gjurma ka me mbetur andej nga ka qenë, mirëpo dalja i jep jashtezakonisht shumë zhvillim Kolovicës.

Petrit Avdullahu, është përmendur Spitali i Qytetit, është përmendur edhe në fushatë, a është ndonjë në plan në Kolovicë.

Arbër Sadiki, tha se janë tri lokacione për Spitalin e Qytetit, një ndër to është edhe Kolovica, por nuk është ende e definuar saktë. Opsionet janë në diskutime.

Petrit Avdullahu- stacionet e autobusit në Kolovicë të gjitha janë ndalesa në rrugë, nuk ka vend të destinuara për stacion.

Arbër Sadiki, e thash edhe më herët, mjetet janë, por nuk i japin pa u rregulluar këto çështje. Në momentin që ne, me një plan të saktë i përmbushim këto çështje, pjese e këtij mobiliteti që jemi duke e bërë me Bankën Botërore, është edhe rishikimi i stacioneve të autobusit. Çdo ndryshim në fillim të prek në mënyrën e përditshme qysh jemi mësuar të jetojmë, por me kalimin e kohës e sheh që ka me qenë shumë më mirë.

Masar Dushi, arkitekt, përfaqësues i Shoqatës së Arkitektëve të Kosovës., tha se e vlerësoj shume nivelin e debatit që është duke u bërë. Ne e përfaqësojmë mendimin kritik, mendimin e trete këtu. Plani zhvillimor komunal është dokumenti kryesor i Komunës së Prishtinës. Kolovica ka shumë emërues të përbashkët me lagjen “Kodra e Trimave”, prona të ngjashme, bile në kisha sugjeruar që të trajtohen bashkarish këto dy lagje. U cek edhe spitali, unë jam kundër asaj që spitali të jete afër qendrës, se ideja është që të shkarkohet qendra, jo të ngarkohet. Ky plan që po e shihni, ka qene pak para aprovimit, mirë që nuk është aprovuar. Rivlerësimi dhe rishikimi i kësaj, kjo është metoda më e mirë nga baza, sa më shumë që ka debate e përplasje këtu, më pak do të ketë telashe në të ardhmen. Këto gjëra lypin kohë dhe durim për me dalë diçka e bukur ne fund.

Mimoza Sylejmani i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Kolovicë, 2022



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina –Municipality of Prishtina

Lista e pjesëmarrësve

Tema: Problematikat e lagjes

Datë: 06/06/2022

Nr.	Emri dhe Mbiemri	E-maili dhe tel.	Nënshkrimi
1	Ardullah Dushi		
2			
3			
4			
5			
6			
7			
8			
9			
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Lista e pjesëmarrësve

Tema: Problematikat e lagjes

Datë: 06/06/2022

Nr.	Emri dhe Mbiemri	E-maili dhe tel.	Nënshkrimi
1	Muharran Zeka		
2	MASAR DUSHI		
3	Nazim Demoll		
4	Muhamet Jahim		
5	Alban Merkulaj		
6	Rastri Det Krasniqi		
7			
8			
9			
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Lista e pjesëmarrësve

Tema: Problematikat e lagjes

Datë: 06/06/2022

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Familja dhe tel	Nënshkrimi
1	ANNI BERISHA		
2	Imen P...		
3	Pelut A...		
4	Avdullah H...		
5	Serdail Gashi		
6			
7			
8			
9			
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Lista e pjesëmarrësve

Tema: Problematikat e lagjes

Datë: 06/06/2022

Nr.	Emri dhe Mbiemri	E-maili dhe tel.	Nënshkrimi
1	XAZMI HUSEINI		
2	Mustafa Krasniq		
3	HARIZ KRASNIQI		
4	LULZIM BUNDAKU		
5	Atdhe Demolli		
6	FISNIK ONMANI		
7	ILIR DUSTAL		
8	Fetjon Jusupaj		
9	BELEN KRASNIQI		
10	U. Demolli		
11	Miftar Muzaj		
12			
13			
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			